VENDIM
Nr.36, datë 7.5.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "EFT ALBANIA" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 13 pikat 1, germa "d", dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave ", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa "a", dhe 3 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.5.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "EFT Albania" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë "EFT Albania" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa "a", "b", "c", "d", "f" dhe "g") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa "a", "b" dhe "d") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "EFT Albania" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta